


| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 |
| 28 | 29 | 30 | 31 | | | |

DONIKA ALICKOLLI

Donika Aliçkolli( Topalli)-nje nder juristet më në zë ne Pogradec, por anetare e forumeve legjislative kombetare, me nje rreth shoqeror-teknik profesionistesh mjaft te njohur ne Shqiperi e me tej. Studio e saj private ndodhet ne pikat qendrore te qytetit; kjo studio e vogel, por me njerez dhe klientë, plot e perplot: jo vetem per biznes, por per lehtesim hallesh, shqetesimesh, padrejtesive te medha qe ka populli me Drejtesine e kompromentuar; qendrova disa ore ne dite ne zyren e saj; kundroja problemet pafund te njerezve pa shkolle e me shkolle, te kamur e te varfer, gra ( sigurisht 80%) dhe burra, te cileve Donika i sqaronte sipas nivelit arsimor-kulturor, moshor dhe social; ajo nuk ankohet kurre dhe mban mend te gjithe klientet, nje hipoteke natyrale, nje enciklopedi urbane dhe nje guxim profesional qytetar per t'u marre shembull; faqja tjeter e medaljes, marredhenia familjare mbetet model; ajo angazhon nje rreth familjar per zgjidhjen a propozimet e deshirave, ngerçeve te shumta te shoqerise sone te lodhur, te nervozuar, te paduruar dhe shpesh me tolerance drejt zeros, por



ku eshte Donika, shkrifton "ujrat" e rrembyera dhe me "shkarpa" te vogla e te medha, te drejta a te shtrembra; mosha ecen edhe per Doniken, por ajo nuk thote kurre JO per trajnime, per kualifikime, tavolina pune e diskutimi, sigurisht edhe per misione shoqerore brenda dhe jashte vendit; ndersa "qershi mbi torte" ka Kontributin e çmuar per emancipimin e gruas ne cdo fushe, edhe ne biznes! Eshte nje gur i rende edhe ne shoqaten tone; gazetaret kane mjaft "brume" per keto heroina provinciale, te pafjale, pa mburrje dhe te ndergjegjshme qe pertej interesave personale gjejne hapesire jo te vogel per t'i dhene Shoqerise civile!





Jo me kot takohem me profesoret, ishim 6, por mira u largua per nje pune tjeter , por edhe pese ishim mjaft per te biseduar jo vetem per ushqimin e veshjet, kohen dhe njerezit por per ceshtje komune, sit e permiresojme mjedisin e infektuar njerezor jo vetem natyror, sigurisht ai natyror u ndot e pastaj e ndjeu ai njerezor I cili me deshit a pa deshire prishi nje ekuiliber dhe duhet dyfishi I kohes per ta ndrequr, per te mos kauar ne fatalitet edhe une prandaj punoj e rri ne shqiperis sepse ende kam shprese, tek dija, edukata, ndergjegja dhe pergjgegjshmeria; onkretisht mua me rreh te ekonomia, sipermarraj femerore e cila mbulom mi 30 % te biznesit femeror perfhsire te artizanatin, biznesin evogel te mesmin dhe ate vip; qe te permbeldhesh kete asset dhe te ndertosh platform e strategji, rekomandime dhe alternative zhvillimore te ketij grupi sigurisht kerkon studime, fakte, kerkimi, praktika te mira dhe vullnet edhe

te grupeve intelektuale universitare; edhe une kete ngrita ne takimin me profesoret enderuara ; ne mjedise kafenej bregdetare, por e vlefshme san je tavoline errumbullaket luksoze me dosje e stilolapsa, me median prane dhe servirjet e rastit; ky eshte emntaliteti burokratik, por ime dhe grupi qe perfaqesoj eshte me praktik, arrin ta thjeshtoje fasaden dhe te forcoje permbajtjen nga ku vjen nje produkt real. thnx



*Pjesemarrja e te rinjve ne intervista studimore tregon perfshirjen e rinise tashme ne drejtim, menaxhim, orientim dhe integrim I forces, energjise dhe kapaciteve rinore ne te gjitha fushat; nje nder to eshte edhe Deni, I cili me shume korrektese, pergjegjesi dhe aftesi plotesoi nje grup pyetjesh te nje formulari me shume te panjohura; rezultati i gjithe pergjigjeve te anetareve te NBF do te sjelle nje produkt real te situates se biznesit ne Shqiperi si dhe pengesat dhe sfidat e tij 2017-2020. Ruaj respekt dhe motiv per te punuar kur ballafaqohem me keto kategori djemsh dhe vajzash te arsimuar dhe te perulur ndaj punes e perkushtimit. Eshte detyre jona t'ia lehtesojme sa me shume shtegjit e veshtira te jetes*

Zyrat ku ti punon jane multifunksionale, por kryesorja eshte : mjedis komod per te bashkebiseduar dhe per te marre e dhene pervoje ; per te programuar aktivitete e forume ne te ardhmen. Nje takim mjaf miqesor dhe zyrtar midis nje perfaqesue se GIZ dhe konsullën e nderit te Shqiperise ne Gjermani, znj. Anduena Stefan




Beauty Plus






**Farmaci KETI,** njihet nga i gjithe qyteti i Pogradecit: se pari eshte farmaciste e mire, keshilluese, e perpikte ne orare dhe ne ilaçe, e kujdeshme ndaj pacienteve dhe humane ndaj te varferve dhe te njerezve ne nevoje ; cilesite e saj personale jane ne perputhje te plote me karakteristikat e nje biznesi funksional, me rregulla, i ndershem dhe ne sherbim te bleresve ; Keti, kur hapi kete biznes, dy vajzat i kishte te vogla dhe bashkeshorti, nder mjeket me te mire te qytetit, pergatiste dokumentet per pension; si qytetare origjinale, ajo nuk mjaftohet me profesionin, por ne kohen e lire merret me grupin e kengeve popullore, lexon dhe shetit ne vende te huaja , kur ka mundesi te beje nje turizem te larte; biznesi i saj eshte shendetesor por edhe social, te cilin e vijon krejtesisht sipas ligjeve ne fuqi dhe me

korrektesine e vjeter qe mesa duket po largohet nga zakonet e njerezve ; Keti eshte edhe nje aktiviste e perhershme e shoqates sone qe ne vitet 2000.

**Ferma e arkitektes:**ne zonat e civilizuara ndodh edhe kjo:arkitektja qe nderton pallate, rruge etj ben edhe fermeren,Vali











## Ne maje te kalase:

Ne kalane e Pogradecit, 800 metra mbi nivelin e detit jetohet me te gjitha produktet bio, te prodhuara nga toka e bekuar jona; sigurisht nuk eshte lehte, as ne dimer as ne vere, as me drita e as me uje, as me infrastrukturen terribel, ku ferrat e guret e rastit te behen shkalle, te çjerrin e shpesh edhe te rrezojne; megjithate banoret e familjaret e bejne kete cdo dite, pese deri 9 here ne dite; ketu kualiteti i jetes eshte cilesor, eshte i kuruar, eshte inovator dhe mjaft mikprites; aty nuk ka ankesa, as zemerime, por buzeqeshje dhe respekt te sinqerte ndaj njeri-tjetrit e ndaj mikut; gostitja eshte aq origjinale sa gezohesh jo vetem se po te ofrojne lakrorin me dy peta, buken me qiqrra, djathin e dhise, mishin e kecit, rakine dhe veren te bere vete, kosin e trashe te sapo- zene, frutat e stines nga kopshti i tyre, sallatat e shumellojshme, turshite e embla dhe kompostot bio; pra keto hane keshtu bio, prandaj nuk shtremberojne fytyren kur i vijne miqte, si tek Ne, qytetaret e "kulluar"; te vjen turp qe po i lodh keta njerez kaq

gjeneroze. Asnje pushtet , as lokal e qendror, as donator e as VIP-at nuk i llogarisin keta "heronj punetore" te se perditshmes brilante jetesore.









## Nevoja e nje mjedisi vetem per grate artizane eshte emergjence:





Tenda te improvizuara, litare te vendosur ne mure, tavolina te vjetra druri a plastike, gjenden ne te gjitha qytetet turistike, te mbushura me produkte artizanale te zakonshme, mbulesa, çentro, bluza apo qarcafe, bluza apo triko, çorape apo shami, unaza apo varese, piktura apo komposto, trahana apo reçel e cdo gje tjeter e bere me dore qe ofrohet nga grate mjeshtre per nje vlere shume te vogel sesa vertet i ka kushtuar prodhueses; nese ka mjeshtri qe eshte kthyer ne biznes dhe qe eshte edhe art, edhe tradite, por qe nuk nxjerr shpesh as buken e gojes eshte ARTIZANATI...te pakten deri tani ; Maqedonia fqinje, me e vogel se ne, me pak e zhvilluar se ne, ka krijuar dyqane te bukra dhe qendra artizanale dinjitoze dhe gjithe vjetore per kategorine e artizanateve te shumta, te cilat ne numer

jane me te vogla e me pak te bukra se ne, por qe shteti e pushteti i promovon dhe i ndihmon. Po tek Ne, deri kur ?????

## Aty ku puna e ndershme mesohet qe ne familje





Ky djale qe ju shihni, eshte pogradecar, lindur, rritur e banues ne Pogradec; i mora leje ta fotografoja ; dy miqte e mi kishin 6-7 vite qe e njihnin, ndersa une pothuaj tre vjet me pare ; e quajne Xhulio Hiçkollari ; tani eshte 20 vjec, por... njohja me të filloi ne kohe vere, kur si femije, vinte ne cdo tavoline kafeje te shiste lajthija ; i sjellshem, i edukuar dhe i pergatitur me teknikat e shitjes, dhe keshtu ne e shume te tjerë ia blinim edhe kur nuk donim ; ruan ende buzeqeshjen e femijerise ; vijon edhe tani te shese lajthi, .por ne tetor niset per në Turqi, sepse tashme ai ndjek universitetin turk ne Ankara, ne anglisht, student i vitit te dyte, dega fizike, me rezultate shume te mira; pa support ekonomik nga prinderit, pa miq e pa pasuri, por me vullnet dhe synime te larta : shkollim dhe punesim per nje jete me te mire e cilesore; jam shume e bindur se ne familje lind gjithcka, e mira dhe e keqja, deshtimi dhe fitorja, dashuria dhe sherri, edukata dhe injoranca, pastaj hyn ne pjese shoqeria ; prandaj askush mos te ngarkoje askend per deshtimet-zanafillen e kane te vatra familjare.

## Turizem kulturor:





Njihet deshira e njerezve te kulturuar e te apasionuar per muze e atelje, per histori e monumente ; kur shkon ne Fier, pakkush nuk ndalon tek muzeu i Apollonise;nuk eshte vetem kuriozitet, as hulumtim siperfaqesor, por nje mundesi zbulimi te antikes, te historise se lashte te popullit tone, por njerezit e artit e te artizanatit aty gjejne modele, dizajne, formave dhe struktura te perdorimit te mjeteve te perditshme te duhura qe nga antikiteti; nga keto eksponate mund te gjenden mjaft gjera te reja dhe mundesi inovacioni modern per ditet e sotme sidomos per biznesin kulturor agroturizmin dhe rigjallerimi e traditave tona.

## FJETJA E SHEN MERISE :

Kjo kisha ortodokse, ne Pogradec, ne zonen e pazarit te vjeter te qytetit liqenor, eshte rinovuar dhe pasuruar me mjedise te pastra, te qeta dhe me dokumente origjinale te historise se saj ; pervec abazhurit te ndrithsem, kupoles se mrekullueshem dhe pikturave shumengjyreshe te shenjtoreve, te bie ne sy numri i madh i shenjtoreve gra, te gjitha te dëlira dhe me emertime jo vetem religjoze, por edhe te diteve te javes, shene premte, shen e diel, shen etj ; mesa duket cdo dite te javes ka nga nje shenjtore, sepse grate vertete jane shenjtore te familjes : punojne, lajne, gatuajne aq mire e shijshem, hekurosin, shtrojne e mbulojne femijte, presin e percjellin miqte me buzen ne gaz dhe me miresi pafund; grate pogradecare jane realisht te tilla.


SHËN E PREMTE
SHËN E DJELA


SHËN OLIMBIA
SHËN SOFIA


E DJELA
SHËN ATHINA


SHËN KATERINA
SHËN THEODHORA
SHËN ANA
SHËN VARVARA

# PERGATITI

# FLUTURA XHABIJA